



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 6318 prot.

Tiranë, më 13.12.2025

NJOFTIM

PËR VEND PUNE

**PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË VLERËSIMEVE DHE ARRITJEVE KOMBËTARE, NË DREJTORINË E VLERËSIMIT
TË ARRITJEVE DHE PERFORMANCËS ARSIMORE, PRANË QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr., 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr.32, datë 18.02.2025, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore", Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton shpalljen e vendit të lirë të punës:

1. Në pozicionin e përgjegjës në Sektorin e Vlerësimeve dhe Arritjeve Kombëtare, në Drejtorinë e Vlerësimit të Arritjeve dhe Performancës Arsimore . Ai/Ajo punon nën drejtimin e Drejtorit të Drejtorisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së, si pjesë e ekipeve të punës brenda institucionit dhe bashkëpunon me pjesëtarët e tjerë të stafit. Përgjegjësitë e pozicionit përfshijnë një gamë të gjerë të çështjeve të cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve, të pranimit në shkollat e larta dhe të provimeve.
2. Kualifikimet, aftësitë dhe eksperiencat që kërkohen për këtë vend pune janë:
 - ✓ Diplomë universitare në fushën e arsimit, preferohet në Gjuhë Shqipe – Letërsi ose Matematikë.
 - ✓ Të ketë minimumi 3 vite përvojë pune në fushën e arsimit, preferohet në vlerësime arsimore, hartim testesh, analiza të dhënash ose koordinim projektesh.
 - ✓ Të ketë eksperiencë të dëshmuar në drejtimin e ekipeve, menaxhimin e proceseve dhe koordinimin e burimeve njerëzore.
 - ✓ Të zotërojë aftësi të forta organizative, duke përfshirë planifikimin, mbikëqyrjen dhe ndjekjen e proceseve të punës.
 - ✓ Të demonstrojë aftësi të shkëlqyera vendimmarrjeje, bazuar në të dhënat dhe analizat e vlerësimeve.
 - ✓ Të ketë aftësi të avancuara komunikimi institucional, përfaqësim profesional dhe bashkëpunim me institucione kombëtare.
 - ✓ Të ketë përvojë në përgatitjen dhe mbrojtjen e raporteve analitike, përmbledhjeve teknike dhe dokumenteve zyrtare për proceset e vlerësimit.
 - ✓ Të zotërojë njohuri të plota mbi ciklin e vlerësimeve arsimore (planifikim, hartim testesh, pilotim, administrim, kodim, analizë të dhënash, raportim).
 - ✓ Të ketë aftësi të monitorojë cilësinë e proceseve në çdo fazë dhe të garantojë zbatimin e protokolleve sipas standardeve të QSHA dhe institucioneve kombëtare.
 - ✓ Të jetë në gjendje të identifikojë problematikat operative, të propozojë zgjidhje dhe të ndër marrë masa korrigjuese në kohë.
 - ✓ Të ketë njohuri shumë të mira mbi menaxhimin e riskut dhe procedurat e sigurisë së materialeve konfidenciale të testimit.
 - ✓ Të ketë përvojë në hartimin e detyrave të punës, udhëzimeve, afateve dhe monitorimin periodik të realizimit të tyre.
 - ✓ Të ketë përvojë në menaxhimin e komunikimit me administratorët e testeve, shkollat pjesëmarrëse dhe palët e interesit.
 - ✓ Aftësi shumë të mira në përdorimin e të dhënave statistikore dhe interpretimin e raporteve të analizës, duke mbështetur vendimmarrjen institucionale.
 - ✓ Të jetë i aftë të përfaqësojë sektorin dhe institucionin në takime, trajnime, prezantime dhe procese auditimi brenda dhe jashtë institucionit.
 - ✓ Të tregojë integritet, përgjegjësi dhe aftësi të lartë për të garantuar besueshmërinë dhe cilësinë e vlerësimeve arsimore.
 - ✓ Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe me afate të ngushta kohore.
 - ✓ Të ketë aftësi të ndjekë dhe menaxhojë disa detyra në të njëjtën kohë.
 - ✓ Të tregojë përkushtim ndaj misionit dhe qëllimeve të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
 - ✓ Njohja e mirë e legjislacionit arsimor shqiptar, politikave të vlerësimeve arsimore dhe të strategjive të zbatimit të këtyre politikave përbën avantazh.

Paga për pozicionin është në kategorinë III-2.

3. Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 06.01.2026 në sekretarinë e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë, QSHA, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 23, Tiranë, këto dokumente: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave, fotokopje të librezës së punës, fotokopje të certifikatave të kualifikimit, dëshmi të gjuhëve të huaja dhe të kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, raportin mjekësor për aftësinë në punë, të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për t'u kontaktuar, si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Njoftimi për shpalljen e këtij vendi të lirë pune mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida Myrto

Bulevardi Zhan D'Ark Nr. 23, Tiranë

Web site: www.qsha.gov.al